

## GjiroArt – E ardhmja e frymës tradicionale të Gjirokastrës

“Isha vetëm 17 vjeç kur fillova të endja në ndërmarrjen artistike të Gjirokastrës,” shpjegon Leonara Cici, një prej 300 punonjësve që humbën të ardhurat kur ndërmarrja u mbyll në mes të traziorave ekonomike e politike të fillimviteve 1990-të.

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve që pasuan, Leonara vazhdoi të punonte me gjilpërë dhe të endte nga dhoma e ndenjes. Megjithatë, donte shumë të rifillonte punë në tezgjah. Kur Lubjana Baoja hapi Gjiro Art, një shoqatë artizanësh, Leonara u mrekullua. “Kur Lubjana mblodhi gratë nga Gjirokastra për të ringjallur qëndisjen në qytet, nuk i gjeja dot fjalët për të shprehur sa e lumtur isha,” thotë Leonara.

## GjiroArt - Crafting the Future of Gjirokastra's traditional spirit

“I was only 17 when I began to weave at the Artistic Enterprise in Gjirokastra”, explains Leonara Cici, one of the 300 employees who lost her livelihood when the enterprise closed amidst the economic and political turmoil of the early 1990s.

Over the next fifteen years, Leonara continued to do some needlework and sewing out of her living room. Yet she always longed to resume her work at the loom. When Lubjana Baoja opened Gjiro Art, an artisan's association, Leonara was thrilled. “When Lubjana gathered women from Gjirokastra to revive weaving in the town, I could not find words to express my happiness”, states Leonara.



*Leonara punon një rugicë të vogël prodhuar me materiale të ricikluara në qendrën GjiroArt në zemër të qendrës së Zonës së Trashëgimisë Botërore mbrojtur nga UNESCO.*

*Leonara is working on a small carped made out of recycled material at the GjiroArt center in the heart of the UNESCO World Heritage site.*

Më kryesorja në misionin e GjiroArt është të rilindet kultura e pasur artizanale e qytetit – nga gdhendja në gur dhe dru, tek përpunimi i metaleve dhe qëndisja. “Në fillim nuk ishim të organizuar fort mirë dhe nuk ia kishim idenë se çfarë na priste në të ardhmen,” shpjegon Lubjana, drejtoreshë ekzekutive e shoqatës.

Për më tepër, artizanët e zonës parapëlqenin që të punonin më vete. “Ishte shumë e vështirë të luftoje kundër mentalitetit të artizanëve për të punuar vetëm, edhe pse ata kishin vështirësi për të shitur produktet e tyre. Të gjithë kishin të njëjtat modele ndërkohë që tregu ishte i mbushur me mallra të lira kineze,” vazhdon Leonara. “Kur RisiAlbania na ndihmoi të zhvillim një plan biznesi të plotë 3-vjeçar, ishte si dhuratë për krishtlindje. Tani kemi mundësinë të zgjerojmë aktivitetin dhe ta fuqizojmë markën tonë, GjiroArt.”

GjiroArt ka ndryshuar shumë në dy vitet e fundit. Me mbi 45 artizanë nga Gjirokastra, Përmeti, dhe Tepelena, GjiroArt jo vetëm merr pjesë në shumë panairë dhe zhvillon trajnime për dizajn dhe marketing për anëtarët, por është bërë aktive edhe në rikthimin e veçorive historike të Gjirokastrës: artizanët e GjiroArt gdhendin punimet e ekspozuara në gur dhe gdhendin me dorë punimet e drurit në hotelet e restorantet nëpër qytet.


GjiroArt dëshiron edhe të nxisë të rinjtë që të angazhohen në punën artizanale. Shoqata ka ngritur “Inkubatorin e zejeve,” i cili ofron trajnim për brezin e ri të artizanëve me ndihmën e zejtarëve me më shumë përvojë, si Leonara.

Central to GjiroArt mission is to revive the town’s rich artisanal culture - from stone and wood carving, metal processing to weaving and embroidering. “At the beginning we were not well-organized and we had no idea what to expect from the future”, explains Lubjana, the association’s Executive Director.

Moreover, artisans in the area preferred to work by themselves. “It was very hard to fight against the artisans’ mentality to work alone, even though they had difficulties selling their products. They all had the same models while the market was full of cheap Chinese products”, continues Leonara. “When RisiAlbania helped us develop a thorough 3-year business plan it was like a Christmas gift. Now we have the possibility to expand our activity and empower our brand, GjiroArt.”

Much has changed in the last couple of years. With more than 45 artisans from Gjirokastra, Permeti and Tepelena, GjiroArt is not only participating in numerous fairs and holds trainings on design and marketing for its members, but also has become active in restoring historical features of Gjirokastra: GjiroArt’s artisans chisel on exposed stonework and hand carve ceiling woodwork in hotels and restaurants around the town.

GjiroArt also seeks to encourage youth to become involved in artisanal craftsmanship. The association set up the “Crafts Incubator”, which provides training to the upcoming generation of artisans with the help of more senior craftswomen such as Leonara.



“Në çdo familje gjirokastrite, është një anëtar që merret me punime dore tradicionale. Duam ta ruajmë dhe ta zhvillojmë më tej traditën e bukur të zejtarisë të Gjirokastrës,” shton Lubjana. Kur sheh sa e kënaqur është Leonara teksa end në tezgjah, bëhet e qartë se sa domethënëse është puna e GjiroArt për gratë në Gjirokastrë.

“In every Gjirokastra family, you have one member who is engaged in traditional handicraft. We want to preserve and further develop the beautiful craftsmanship tradition of Gjirokastra”, adds Lubjana. Looking at the Leonara’s delight while weaving, it becomes clear how meaningful GjiroArt’s work is for women in Gjirokastra.